



OSHEE GROUP njofton mbi hapjen e vendit vakant Operator Nën Stacioni pranë OSSH sh.a. Drejtoria e Tensionit të Lartë / Njësia Veri / Dega Teknike / Sektori i Shfrytëzimit / NSt.Shkodër / Nst. Vau i Dejës 110/6kV

OPERATOR NËN STACIONI

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për kryerjen e detyrës funksionale në përputhje me instruksionet e dispeçerisë.
- Përgjegjës për kryerjen e të gjitha punëve të nevojshme dokumentative (raportet operative, mirëmbajtjet e kryera, raportimi i ngjarjeve teknike, etj).
- Hartimi i listës për materialet e nevojshme për funksionimin e Nën Stacionit.
- Përgjegjës për krijimin e listës për riparimet e nevojshme në Nën Stacion.
- Përgjegjës për zbatimin e grafikut të turneve, të kryer nga Përgjegjësi i Nën Stacionit.
- Aktivitete të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të zotërojë diplomë të Arsimit të Mesëm, preferohet i Mesëm Profesional ose Çertifikatë të profilit Elektrik.
- Të ketë aftësi shumë të mira të etikës dhe komunikimit.
- Të kryej detyrat e ngarkuara me përgjegjësi.
- Të ketë aftësi për të punuar në grup.

Dokumentat për dorëzim:

- Curriculum Vitae (CV).
- Letër Interesi – në të cilën duhet të specifikohen arsyet të cilat ju mendojnë se ju bëjnë një kandidat potencial për këtë pozicion.